

METODOLOGJI

për monitorimin e zbatimit të

Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e
Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026–2030
dhe Planit të veprimit për zbatimin e saj 2026-2030



Financuar nga
Bashkimi Evropian



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕЃУНАРОДНА
СОРАБОТКА

Titulli: Metodologji për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026–2030 dhe Planit të veprimit për zbatimin e saj 2026-2030

Botues: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS)

Autorë: Snezhana Kamillovska Trpovska dhe Lejla Tutiq (MCMS)

Përkthim nga maqedonishtja në shqip: Gramoz Shabani

Dizajni: Kontura DOO Shkup

Shkup, korrik 2026

Ky botim është financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e autorëve Snezhana Kamillovska Trpovska dhe Lejla Tutiq dhe nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Riprodhimi, kopjimi, transmetimi ose përkthimi i çdo pjese të këtij botimi mund të bëhet vetëm me lejen paraprake të botuesve, për qëllime citimi në një recension libri dhe sipas kushteve të përcaktuara më poshtë.

Ky botim është i mbrojtur nga të drejtat e autorit, por mund të riprodhohet në çdo formë pa pagesë për qëllime edukative. Për kopjim në kushte të tjera, për përdorim në botime të tjera ose për përkthim ose përshtatje, duhet të merret leje paraprake nga botuesit.

Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Qëllimi i metodologjisë	5
3. Fusha e monitorimit	6
3.1. Kriteret për prioritizimin dhe intensitetin e monitorimit të Strategjisë Kombëtare	6
3.2. Përfshirja institucionale	7
4. Qasja metodologjike bazë për masat e monitorimit	8
4.1. Monitorimi i nivelit të zbatimit të aktiviteteve	8
4.2. Monitorimi i efekteve të menjëhershme të zbatimit	8
4.3. Monitorimi i implikimeve financiare	9
5. Burimet e të dhënave dhe metodat e mbledhjes së të dhënave	10
5.1. Hulumtim i literaturës	10
5.2. Raportet nga përdoruesit e platformës	10
5.3. Kërkesat për qasje në informacion publik	11
5.4. Metoda të tjera cilësore	11
6. Vlerësimi i shkallës së zbatimit: sistemi i semaforëve	12
7. Matja e efekteve: një qasje e bazuar në një situatë të re praktike	13
7.1. Efekti – po	13
7.2. Efekti – i kufizuar ose i paplotë	13
7.3. Efekti – nuk mund të vlerësohet	14
7.4. Efekti – jo (pa efekt)	14
8. Monitorimi financiar i zbatimit të Strategjisë	15
8.1. Semafori financiar	15
9. Verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave	17
10. Prezantimi i të dhënave në platformë	18
10.1. Renditja e institucioneve	18
11. Rreziqet që lidhen me mosmiratimin ose zbatimin e Strategjisë	20
11.1. Rreziku i mosmiratimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit	20
11.2. Rreziqet e ngecjes ose zbatimit të pamjaftueshëm	20
12. Kufizimet e metodologjisë	22
13. Vërejtje përfundimtare	23

1. Hyrje

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026–2030 është i rëndësishëm jo vetëm për të përcaktuar se çfarë është planifikuar, por edhe për të përcaktuar se çfarë po zbatohet në të vërtetë, brenda çfarë afati kohor, me çfarë burimesh dhe me çfarë rezultatesh. Përvoja e deritanishme tregon se edhe dokumentet strategjike më të përgatitura nuk sjellin ndryshime vetë. Ndryshimi varet nëse masat dhe aktivitetet zbatohen, nëse institucionet marrin përgjegjësi për detyrimet e tyre, nëse ka mbështetje të mjaftueshme financiare dhe nëse publiku mund të njohë një efekt konkret në praktikë. Kjo Metodologji përcakton një qasje të qartë, praktike dhe të kuptueshme publikisht për monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit për zbatimin e saj. Monitorimi do të mbulojë të gjithë Planin e veprimit, d.m.th. të gjitha masat dhe aktivitetet e parashikuara në të, me aktivitete që monitorohen me intensitet të ndryshëm në varësi të afateve të tyre, rëndësisë, rreziqeve dhe disponueshmërisë së të dhënave.

Metodologjia bazohet në disa parime themelore: mbulim i plotë i Planit të veprimit, kriteret e qarta për priorizimin e monitorimit, gjetje të verifikueshme, përdorim i burimeve të shumëfishta të të dhënave, kryqëzim i informacionit, një sistem semaforësh për shfaqjen e statusit të zbatimit, monitorim i efekteve të menjëhershme dhe monitorim i veçantë i mbështetjes financiare pas aktiviteteve.

Vëmendje e veçantë i kushtohet ndryshimit midis përmblotjes formale dhe ndryshimit aktual në praktikë. Prandaj, metodologjia nuk kufizohet vetëm në pyetjen nëse një aktivitet i caktuar është përfunduar, por kontrollon edhe nëse realizimi i tij ka krijuar një gjendje të re praktike që mund të shihet, përdoret ose verifikohet.

Rezultatet e monitorimit do të paraqiten përmes një platforme publike interaktive, e cila do të ofrojë informacion mbi statusin e aktiviteteve, institucionet kompetente, afatet, efektet, mbështetjen financiare dhe burimet e të dhënave. Platforma gjithashtu do të ofrojë një pasqyrë institucionale të zbatimit, si dhe mundësinë e përdorimit të informacionit dhe raporteve nga përdoruesit si një sinjal shtesë për kontrollin e situatës në praktikë.

Metodologjia i merr në konsideratë gjithashtu rreziqet që lidhen me një vonesë ose dështim të mundshëm në miratimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit, si dhe rreziqet e ngecjes ose zbatimit të pamjaftueshëm pas miratimit të tyre. Në raste të tilla, monitorimi do të mundësojë një analizë të arsyeve të ngecjes, veprimit institucional, transparencës së procesit dhe faktorëve që ndikojnë në zbatim.

Metodologjia në fjalë është zhvilluar në kuadër të projektit “Ndërtimi i një shoqërie rezistente ndaj korrupsionit”, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian, brenda të cilit do të kryhet monitorimi sistematik i zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit përmes një mekanizmi të krijuar për monitorim, vlerësim dhe raportim të rregullt.

2. Qëllimi i metodologjisë

Qëllimi i kësaj metodologjie është të krijojë një mekanizëm të qartë, të qëndrueshëm dhe të verifikueshëm për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026-2030. Ajo duhet të sigurojë:

- A po zbatohen masat dhe aktivitetet nga Plani i veprimit në përputhje me afatet dhe detyrimet e përcaktuara;
- A mund të përcaktohet shkalla e përmbushjes së detyrimeve nga institucionet kompetente nëpërmjet një prezantimi krahasues të numrit të masave dhe aktiviteteve për të cilat ato janë përgjegjëse dhe shkallës së zbatimit të tyre;
- A çuan aktivitetet e zbatuara në një situatë të re praktike që mund të shihet, përdoret ose verifikohet;
- Nëse ofrohet mbështetje e mjaftueshme buxhetore për masat dhe në çfarë mase zbatohet ajo;
- A ka publiku qasje në të dhëna të sistematizuara dhe të krahasueshme mbi nivelin e zbatimit;

3. Fusha e monitorimit

Monitorimi do të mbulojë të gjithë Planin e veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026–2030, pra të gjitha masat dhe aktivitetet e parashikuara në të. Fusha e monitorimit nuk kufizohet vetëm në fusha, institucione ose aktivitete specifike, por synon të ofrojë një pasqyrë të plotë dhe të krahasueshme mbi nivelin e zbatimit të Strategjisë.

Njësia bazë e analizës do të jetë aktiviteti, pasi është aktiviteti në Planin e veprimit që përcaktohet më qartë përmes institucionit përgjegjës, afatit, rezultatit të pritur dhe treguesit. Megjithatë, gjetjet do të përmbledhen dhe do të paraqiten në nivel mase, fushe/ sektori, institucioni përgjegjës dhe të gjithë Strategjisë, në mënyrë që të merret një pamje më e gjerë e progresit dhe shpërndarjes së përgjegjësisë midis institucioneve.

Kjo qasje lejon monitorimin si të përmbushjes formale të aktiviteteve ashtu edhe të progresit më të gjerë në zbatimin e masave. Është veçanërisht e rëndësishme sepse disa nga masat përbëhen nga aktivitete të shumëfishta, ndërsa në të tjerat masa reduktohet në një aktivitet të vetëm. Prandaj, metodologjia nuk krijon një sistem paralel, por ndërtohet mbi strukturën e Planit të veprimit dhe përdor aktivitetet, afatet, institucionet kompetente dhe treguesit e përcaktuar tashmë.

3.1. Kriteret për prioritizimin dhe intensitetin e monitorimit të Strategjisë Kombëtare

Edhe pse monitorimi do të mbulojë të gjithë Planin e veprimit, jo të gjitha aktivitetet do të monitorohen me të njëjtin intensitet në secilën periudhë raportimi. Arsyeja për këtë është se aktivitetet kanë afate të ndryshme për zbatim, nivele kompleksiteti dhe shkallë gatishmërie për zbatimin e tyre, si dhe rëndësi specifike në një moment të caktuar kohor.

Kriteret e përcaktuara në këtë metodologji nuk kanë për qëllim të përjashtojnë masa ose aktivitete të caktuara nga monitorimi, por më tepër të mundësojnë prioritizimin e monitorimit, përcaktimin e dinamikës së mbledhjes së të dhënave dhe përcaktimin e nivelit të detajeve të analizës.

Aktivitetet e mëposhtme do të monitorohen si përparësi dhe në mënyrë më të detajuar:

- së pari, afati i zbatimit të të cilit bie në periudhën aktuale ose të ardhshme të raportimit;
- së dyti, zbatimi i të cilit është një parakusht për zbatimin e aktiviteteve ose masave të tjera;
- së treti, të cilat janë të rëndësishme për interesin publik, transparencën, llogaridhënien, integritetin e institucioneve ose parandalimin e korrupsionit;
- së katërti, aty ku ekziston rreziku më i lartë i vonesës, përmbushjes formale pa zbatim praktik ose mbështetjes së pamjaftueshme financiare;

- e pesta, për të cilat kanë dalë informacione, raporte, gjetje mediatike ose sinjale të tjera që tregojnë nevojën për verifikim shtesë.

Aktivitetet, afati i të cilave nuk ka mbërritur ende ose për të cilat nuk ka baza të mjaftueshme për shqyrtim të detajuar në periudhën specifike të raportimit, do të regjistrohen në sistem dhe do të shënohen si aktivitete që nuk i nënshtrohen vlerësimit të detajuar në atë periudhë. Kjo siguron mbulim të plotë të Planit të veprimit, por edhe drejtimin racional të burimeve drejt aktiviteteve për të cilat është më e rëndësishme të kryhet monitorim i thelluar.

3.2. Përfshirja institucionale

Metodologjia do të ofrojë gjithashtu një pasqyrë institucionale të zbatimit. Për secilin institucion kompetent, do të përcaktohet numri i masave dhe aktiviteteve për të cilat është përgjegjës, statusi i zbatimit të tyre, shkalla e përmbushjes së angazhimeve të ndërmarra dhe kur është e aplikueshme, mbështetja financiare përkatëse.

Përmbledhja institucionale nuk do të shërbejë vetëm për të numëruar aktivitetet e zbatuara dhe të pazbatuara, por edhe për të kuptuar më mirë shpërndarjen e përgjegjësi-ve, barrën mbi institucionet dhe vonesat e mundshme në zbatim. Cjatë interpretimit të të dhënave, do të merret parasysh numri, afatet, kompleksiteti dhe natyra e aktiviteteve për të cilat është përgjegjës secili institucion.

Kjo qasje lejon prezantimin jo vetëm të progresit të përgjithshëm në zbatimin e Strategjisë, por edhe të shkallës së përgjegjësisë dhe llogaridhënies institucionale në zbatimin e saj.

4. Qasja metodologjike bazë për masat e monitorimit

Metodologjia bazohet në tre shtylla të ndërlidhura: monitorimi i zbatimit, monitorimi i efekteve të menjëhershme dhe monitorimi i implikimeve financiare.

Monitorimi do të mbulojë të gjithë Planin e veprimit, pra të gjitha masat dhe aktivitetet e parashikuara në të. Megjithatë, aktivitetet nuk do të monitorohen me të njëjtin intensitet në secilën periudhë raportimi.

4.1. Monitorimi i nivelit të zbatimit të aktiviteteve

Shtylla e parë ka të bëjë me faktin nëse aktivitetet nga Plani i veprimit po zbatohen në përputhje me afatet, përgjegjësitë dhe treguesit e parashikuar. Monitorohen si aspektet formale ashtu edhe ato faktike të zbatimit: nëse aktiviteti ka filluar, nëse është përfunduar, nëse ka përfunduar në kohë dhe nëse ka prova të verifikueshme për këtë.

4.2. Monitorimi i efekteve të menjëhershme të zbatimit

Shtylla e dytë përqendrohet te efektet, por në një nivel realist dhe të verifikueshëm. Në vend që të pretendojë se çdo masë e zvogëlon menjëherë korrupsionin ose e ndryshon plotësisht sjelljen e institucioneve, ajo kontrollon nëse aktiviteti ka krijuar një situatë të re praktike që mund të shihet, përdoret ose verifikohet.

Kjo do të thotë që, nëse është miratuar një ligj, kontrollohet nëse ekziston një kuadër normativ i ri dhe i zbatueshëm; nëse është krijuar një modul elektronik, nëse ai është i arritshëm dhe funksional; nëse parashikohet publikimi i të dhënave, nëse ai është vërtet publik, i plotë dhe i përdorshëm.

Me këtë qasje, metodologjia nuk premtan më shumë sesa mund të matë. Në vend të pretendimeve të gjera dhe të vështira për t'u vërtetuar, ajo përqendrohet në rezultate të menjëhershme që mund të dokumentohen bindshëm.

4.3. Monitorimi i implikimeve financiare

Shtylla e tretë është monitorimi financiar. Kjo pjesë është e rëndësishme sepse përvoja tregon se një pjesë e mirë e masave mbeten në letër kur nuk ka planifikim, sigurim dhe përdorim në kohë të fondeve. Vetë korniza strategjike tregon se planifikimi i pamjaftueshëm i buxhetit dhe mungesa e monitorimit sistematik të burimeve ishin dobësi edhe në ciklet e mëparshme.

Monitorimi financiar do të kryhet në dy nivele: në nivelin e një mase ose aktiviteti individual dhe në nivelin e të gjithë Strategjisë. Dy herë në vit, do të kontrollohet nëse institucioni kompetent ka kërkuar fonde, në çfarë shume, nëse këto fonde janë miratuar dhe cila pjesë e tyre është zbatuar.

Në këtë mënyrë, nuk monitorohet vetëm nëse një masë zbatohet formalisht, por edhe nëse ajo është njohur si prioritet buxhetor dhe nëse ka marrë mbështetje të vërtetë financiare. Statusi financiar do të shfaqet veçmas nga statusi i zbatimit, pasi një aktivitet mund të vonohet për shkak të mungesës së fondeve, por mund të ketë edhe një situatë të kundërt - fondet mund të sigurohen, por aktiviteti mund të mos zbatohet ende.

5. Burimet e të dhënave dhe metodat e mbledhjes së të dhënave

Monitorimi do të bazohet në një kombinim të burimeve të të dhënave parësore dhe dytësore, në mënyrë që gjetjet të jenë sa më të plota, të verifikueshme dhe të kryqëzuara.

5.1. Hulumtim i literaturës

Hulumtimi nga zyra do të jetë një metodë e vazhdueshme për mbledhjen dhe analizimin e informacionit të disponueshëm publikisht. Ai do të përfshijë një shqyrtim sistematik të faqeve zyrtare të internetit të institucioneve, “Gazetës zyrtare”, raporte, strategji, plane veprimi, akte nënligjore, vendime, protokolle, doracak, baza të dhënash publike, regjistra, portale dhe dokumente buxhetore.

Përmes kësaj metode, do të jetë e mundur të monitorohet rregullisht progresi formal, të identifikohen provat përkatëse dhe të përcaktohet nëse aktivitetet e zbatuara kanë krijuar një situatë të re konkrete në praktikë.

Përveç kësaj, për të monitoruar efektet do të përdoren njoftime për media, hulumtime gazetareske, njoftime për shtyp, paraqitje publike nga institucionet, reagime të palëve të interesuara dhe burime të tjera të disponueshme publikisht. Ato nuk do të jenë baza e vetme për përcaktimin e zbatimit, por do të ndihmojnë për të parë nëse një aktivitet i caktuar ka krijuar vërtet ndryshime praktike dhe të dukshme.

Ato do të jenë veçanërisht të dobishme për njohjen e efekteve që tashmë po ndihen në praktikë, për të kontrolluar nëse zgjidhjet e reja po zbatohen në të vërtetë dhe për të përcaktuar ndryshimin midis zbatimit formal dhe situatës aktuale.

5.2. Raportet nga përdoruesit e platformës

Metodologjia përfshin gjithashtu shqyrtimin e informacionit të ofruar nga përdoruesit e platformës. Ky burim është i rëndësishëm sepse sjell përvoja nga terreni - nga qytetarët, organizatat, media dhe komunitetet profesionale - të cilat mund të tregojnë zbatim jo të plotë të masave, probleme praktike në funksionimin e sistemeve të reja ose mungesë informacioni të disponueshëm publikisht.

Raporte të tilla nuk do të konsiderohen automatikisht si prova të konfirmuara. Ato do të shërbejnë si një sinjal që duhet të kontrollohet më tej dhe të kryqëzohet me burime të tjera. Kështu, platforma nuk do të jetë vetëm një vend për publikimin e të dhënave, por edhe një kanal për mbledhjen e informacionit se si funksionojnë masat në praktikë.

5.3. Kërkesat për qasje në informacion publik

Një nga instrumentet kryesore për mbledhjen e të dhënave shtesë do të jenë kërkesat për qasje në informacionin publik. Ato do të përdoren kur nuk ka informacion të mjaftueshëm publik mbi statusin e zbatimit, kur është e nevojshme të ofrohen dokumente dhe raporte, kur është e nevojshme të verifikohet nëse aktiviteti është zbatuar në të vërtetë, si dhe kur është e nevojshme të përcaktohet nëse institucioni ka kërkuar, marrë dhe zbatuar fonde.

Ky instrument do të jetë veçanërisht i rëndësishëm për komponentin financiar të monitorimit, pasi të dhënat mbi planifikimin e buxhetit dhe zbatimin e masave specifike shpesh nuk paraqiten qartë dhe në detaje në dokumentet e publikuara publikisht.

5.4. Metoda të tjera cilësore

Përveç burimeve të mësipërme, metodologjia parashikon edhe përdorimin e metodave cilësore për mbledhjen e të dhënave, siç janë grupet e fokusit dhe intervistat gjysmë të strukturuar me përfaqësues të institucioneve kompetente, organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve dhe palëve të tjera të interesuara relevante.

Këto metoda do të përdoren kur nevojitet një kuptim më i thellë i nivelit të zbatimit, kur ka paqartësi ose informacione kontradiktore nga burime të tjera, si dhe për të identifikuar sfidat praktike në zbatimin e masave.

Të dhënat e marra nëpërmjet këtyre metodave nuk do të përdoren si prova e vetme, por do të shërbejnë për të plotësuar dhe për t'u referuar në mënyrë të kryqëzuar me burime të tjera informacioni.

6. Vlerësimi i shkallës së zbatimit: sistemi i semaforëve



Statusi i secilit aktivitet do të përcaktohet përmes një sistemi të thjeshtë semaforësh me katër kategori: jeshile, e verdhë, e kuqe dhe e bardhë.

Statusi i aktiviteteve shfaqet përmes një sistemi vizual semaforësh, i cili lejon monitorim të qartë dhe të kuptueshëm të progresit.

Sistemi përfshin kategoritë e mëposhtme:

- E kuqe – aktiviteti nuk është zbatuar ose afati është shkelur pa përparim;
- E verdhë – aktiviteti është zbatuar pjesërisht ose po zbatohet me devijime;
- Jeshile – aktiviteti është zbatuar plotësisht me prova të verifikueshme;
- E bardhë – aktiviteti nuk ka arritur ende afatin e tij të zbatimit ose nuk është subjekt i monitorimit të vazhdueshëm në periudhën specifike të raportimit.

Vlerësimi i statusit jepet kryesisht në nivel aktiviteti, pasi aktiviteti është njësia bazë e analizës në metodologji. Nëse është e nevojshme, vlerësimet mund të agregohen edhe në nivel mase, fushe/ sektori, institucioni dhe të gjithë Strategjisë.

Metodologjia parashikon monitorim prioritar të aktiviteteve të përzgjedhura, bazuar në rëndësinë e tyre, afatet dhe ndikimin e pritur. Aktivitetet për të cilat afati i zbatimit nuk është përmbushur ose nuk janë në fokus të monitorimit në periudhën e caktuar janë të shënuara me të bardhë, pa një vlerësim të detajuar të statusit të tyre.

Rezultatet e semaforit mund të agregohen edhe sipas institucionit përgjegjës, për të treguar se çfarë proporcioni i aktiviteteve për të cilat është përgjegjës institucioni janë zbatuar, zbatuar pjesërisht, nuk janë zbatuar ose janë ende në pritje. Ky ekran do të marrë parasysh numrin, afatet dhe kompleksitetin e aktiviteteve.

7. Matja e efekteve: një qasje e bazuar në një situatë të re praktike

Matja e efekteve kryhet vetëm për aktivitetet që vlerësohen si të zbatuara plotësisht ose pjesërisht (jeshile ose të verdhë). Për aktivitetet e shënuara me të kuqe ose të bardhë, efekti zakonisht nuk vlerësohet, sepse aktiviteti ose nuk është zbatuar ose nuk i nënshtrohet një vlerësimi të detajuar në periudhën specifike të raportimit.

Matja e efekteve do të bazohet në një pyetje kyçe: a ka krijuar aktiviteti i zbatuar një situatë të re praktike që mund të shihet, përdoret ose verifikohet? Kjo pyetje bëhet pasi të jetë përcaktuar se aktiviteti është zbatuar ose të paktën është zbatuar pjesërisht.

Vlerësimi i ndikimit nuk është një matje e ndikimit afatgjatë, por i referohet rezultateve të menjëhershme dhe të verifikueshme që rezultojnë nga aktiviteti specifik.

Në varësi të përgjigjes, do të përdoren tre nota:

7.1. Efekti – po

Ky vlerësim jepet kur zbatimi i një aktiviteti të caktuar ka çuar në një ndryshim të qartë dhe të dukshëm në praktikë. Me fjalë të tjera, vlerësimi tregon se është bërë diçka konkrete dhe se qytetarët mund ta ndiejnë ndryshimin në praktikë. Për sqarim dhe nëpërmjet një shembulli, kjo është një situatë në të cilën, si rezultat i një ligji të ndryshuar që parashikon një detyrim të detyrueshëm për këtë, informacioni në lidhje me procedurat e prokurimit publik publikohet publikisht, duke i dhënë kështu publikut një pasqyrë të drejtpërdrejtë mbi mënyrën se si shpenzohen paratë publike, të cilat e zvogëlojnë drejtpërdrejt mundësinë e keqpërdorimit.

7.2. Efekti – i kufizuar ose i paplotë

Ky vlerësim përdoret kur ka një ndryshim, por është i kufizuar, i paplotë ose ende jo mjaftueshëm funksional. Ky mund të jetë rasti kur një ligj është miratuar pa legjislacion dytësor, është zhvilluar një modul që nuk përdoret, është formuar një grup pune pa aktivitet ose janë publikuar të dhëna që nuk janë të plota dhe të përdorshme.

7.3. Efekti – nuk mund të vlerësohet

Ky vlerësim përdoret kur natyra e aktivitetit ose faza në të cilën ndodhet nuk lejon përcaktimin e një efekti të menjëhershëm. Në aktivitetet analitike ose përgatitore shpesh është shumë herët për të thënë nëse është krijuar një situatë e re praktike.

7.4. Efekti – jo (pa efekt)

Ky vlerësim përdoret kur aktiviteti është zbatuar zyrtarisht, por ka kaluar kohë e mjaftueshme dhe nuk ka shkaktuar një situatë të re praktike ose një ndryshim real në veprimet e institucioneve.

Rezultatet e vlerësimit (matjes) së efektit të aktiviteteve të zbatuara do të paraqiten në mënyrë narrative dhe të disponueshme publikisht në Platformën interaktive të monitorimit, si dhe brenda raporteve hije të përgatitura.

8. Monitorimi financiar i zbatimit të Strategjisë

Monitorimi financiar është një pjesë integrale e metodologjisë dhe synon të ofrojë informacion nëse aktivitetet e planifikuara mbështeten nga mbështetje e mjaftueshme financiare dhe nëse ajo përdoret në të vërtetë. Monitorimi bazohet në një analizë të planifikimit të buxhetit, miratimit dhe zbatimit të fondeve për aktivitete specifike, duke përdorur të dhëna nga dokumente publike, qasje në kërkesa për informacion dhe burime të tjera relevante.

Monitorimi financiar nuk kryhet i izoluar, por në lidhje me vlerësimin e nivelit të zbatimit me qëllim përcaktimin nëse ndonjë mungesë ose përdorim joefikas i fondeve ndikon në zbatimin e aktiviteteve.

Të dhënat financiare do të monitorohen kryesisht në nivel aktiviteti dhe nëse është e nevojshme, do të përmbledhen në nivel mase, fushe/ sektori, institucioni dhe të gjithë Strategjisë. Do të kontrollohet nëse janë kërkuar fonde për aktivitetin, nëse fondet janë miratuar, në çfarë shume dhe në çfarë mase janë zbatuar, me një regjistër të veçantë të burimit të financimit (nëse fondet janë siguruar nga buxheti i shtetit apo përmes donatorëve të jashtëm).

8.1. Semafori financiar

Shkalla e mbështetjes financiare për aktivitetet shfaqet përmes një sistemi të thjeshtuar semaforësh.

Përdoren kategoritë e mëposhtme:

- E gjelbër – fondet janë kërkuar, miratuar dhe kryesisht janë zbatuar;
- E verdhë – fondet janë miratuar, por zbatimi i tyre është vonuar ose ka një mospërputhje midis nivelit të shumës së kërkuar dhe asaj të miratuar. Në platformë, kjo do të përmbajë një shpjegim të veçantë se ku ka ndodhur vonesa;
- E kuqe – fondet nuk janë kërkuar, janë refuzuar nga Ministria e Financave ose megjithëse janë miratuar, zbatimi është 0%. Arsyeja specifike do të shfaqet në platformë (p.sh. “kërkesë e refuzuar” ose “fonde të paalokuara”);
- E bardhë - gjurmimi financiar nuk është i rëndësishëm në periudhën e dhënë.



Vlerësimi financiar do të jepet veçmas nga vlerësimi i zbatimit të aktivitetit. Kjo është e rëndësishme sepse një aktivitet mund të vonohet për shkak të mungesës së fondeve, por mund të ketë edhe një situatë të kundërt - fondet mund të kërkohen ose miratohen, por aktiviteti prapë të mos zbatohet.

Tabela e rezultateve financiare nuk do të përfaqësojë një vlerësim të pavarur të suksesit të institucionit, por më tepër një tregues shtesë nëse aktivitetet mbështeten nga burime të mjaftueshme dhe nëse këto burime përdoren në funksion të zbatimit të tyre.

9. Verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave

Për të siguruar saktësinë, çdo gjetje duhet të verifikohet përmes të paktën dy burimeve, sa herë që është e mundur. Të dhënat mbi një aktivitet të zbatuar, për shembull, mund të verifikohen përmes një dokumenti zyrtar dhe një postimi në internet; të dhënat mbi efektin praktik përmes një burimi zyrtar dhe konfirmimit nga media ose përdoruesi; dhe të dhënat financiare përmes një dokumenti buxhetor dhe një përgjigjeje ndaj një kërkesë për qasje në informacion.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet dallimit midis:

- përmbushja formale e aktivitetit (ekzistenca e një dokumenti ose vendimi);
- aplikimi aktual (nëse zgjidhja përdoret apo zbatohet në të vërtetë);
- ekzistenca dhe përdorimi i mbështetjes financiare.

Kjo qasje bën të mundur shmangien e vlerësimit të një aktiviteti si “i zbatuar” vetëm në bazë të provave formale, pa kontrolluar nëse ka një zbatim të vërtetë dhe rezultat praktik.

Në rastet kur nuk është e mundur të jepet konfirmim nga burime të shumëfishta, kjo do të deklarohet qartë në shpjegimin e vlerësimit, me qëllim ruajtjen e transparencës dhe për të nxjerrë në pah kufizimet e të dhënave të disponueshme.

10. Prezantimi i të dhënave në platformë

Rezultatet e monitorimit do të publikohen dhe prezantohen në një platformë publike interaktive. Platforma do të mbulojë të gjithë Planin e veprimit, d.m.th. të gjitha masat dhe aktivitetet e parashikuara në të, me mundësinë e shkallëve të ndryshme të detajeve në varësi të periudhës së raportimit, afateve dhe disponueshmërisë së të dhënave.

Të dhënat do të paraqiten në të paktën katër nivele: aktivitet individual, masë, fushë/ sektor dhe e gjithë Strategjia. Përveç kësaj, platforma do të ofrojë edhe një pasqyrë institucionale të zbatimit.

Për çdo aktivitet ose masë, platforma do të përmbajë: emrin, fushën/sektorin, institucionin kompetent, afatin, treguesin nga Plani i veprimit, statusin e zbatimit, vlerësimin e ndikimit, statusin financiar, shpjegimin e shkurtër, burimin ose provat dhe datën e përditësimit të fundit.

Platforma duhet të lejojë filtrimin sipas zonës/sektorit, institucionit, afatit, statusit të zbatimit, statusit financiar dhe vlerësimit të ndikimit. Gjithashtu duhet të lejojë pamje të përgjithshme të numrit të aktiviteteve të gjelbra, të verdha, të kuqe dhe të bardha, një pasqyrë të të dhënave financiare në nivelin e masës, institucionit, zonës/sektorit dhe të gjithë Strategjisë, si dhe një hapësirë për raportet ose informacionet nga përdoruesit.

10.1. Renditja e institucioneve

Platforma interaktive mundëson një shfaqje dinamike të të dhënave përmes funksioneve të veçanta të renditjes dhe filtrimit të institucioneve kompetente, me qëllim që publiku të ketë një pasqyrë të efikasitetit të tyre në zbatimin e Strategjisë. Sistemi i renditjes bazohet në dy parametra kryesorë:

- **Efikasiteti kohor (realizimi i afateve):** Funkzioni lejon gjenerimin automatik të një pasqyre të përgjithshme të institucioneve sipas përqindjes së detyrimeve të përfunduara në kohë (statusi jeshil), në krahasim me ato në të cilat afatet e parashikuara janë tejkaluar ose është regjistruar një ndalesë e plotë e procedurave (statusi i kuq).
- **Progres i konsiderueshëm (efekti i matur):** Kjo renditje bën dallimin midis institucioneve që kanë përmbyshur vetëm formalisht aktivitete (si miratimi i akteve të brendshme, planeve ose rregullave të procedurës pa zbatim praktik) dhe institucioneve, masat e marra të të cilave kanë gjeneruar ndryshime reale dhe efekte të dukshme në praktikë.



Duke aplikuar filtra të avancuar, përdoruesit e platformës mund të zgjedhin institucionet dhe aktivitetet që janë identifikuar si pika kritike në sistem, pra ato me vonesat më të mëdha ose me mungesën e një efekti konkret në politikat antikorrupsion.

11. Rreziqet që lidhen me mosmiratimin ose zbatimin e Strategjisë

Metodologjia merr në konsideratë gjithashtu rreziqet që lidhen me dështimin e mundshëm për të miratuar Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026–2030 dhe Planin e veprimit për zbatimin e saj, si dhe rreziqet e ngecjes, vonesës ose zbatimit të pamjaftueshëm pas miratimit të tyre.

11.1. Rreziku i mosmiratimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit

Nëse Strategjia ose Plan i veprimit nuk miratohet brenda afatit të përcaktuar, monitorimi do të përqendrohet në analizimin e procesit të përgatitjes dhe miratimit të tyre.

Në atë rast, një analizë e veçantë do të vlerësojë rrjedhën e procesit, arsyet e vonesës së mundshme, veprimin institucional, shkallën e transparencës, përfshirjen e palëve të interesuara përkatëse dhe faktorët që ndikuan në vonesë.

Për këtë analizë do të përdoren të njëjtat burime dhe metoda të parashikuara në metodologji, duke përfshirë dokumentet publike, informacionin e marrë përmes kërkesave për qasje në informacion publik, hulumtimin e tavolinave, njoftimeve për media, intervistave, grupeve të fokusit dhe burimeve të tjera relevante.

Gjetjet e kësaj analize do të paraqiten brenda raporteve, si një seksion i veçantë analitik dhe nëse është e nevojshme, ato mund të përfshihen edhe në platformën interaktive, në një formë që i përshtatet natyrës së procesit.

11.2. Rreziqet e ngecjes ose zbatimit të pamjaftueshëm

Nëse Strategjia dhe Plan i veprimit miratohen, por ka vonesë, prolongim ose zbatim të pamjaftueshëm të aktiviteteve të planifikuara, metodologjia do të mundësojë identifikimin dhe prezantimin e rreziqeve kryesore që ndikojnë në zbatim.

Rreziqe të tilla mund të përfshijnë veprime të parakohshme nga institucionet kompetente, koordinim të pamjaftueshëm ndërinstitutional, mungesë burimesh financiare, përgjegjësi të paqarta, transparencë të kufizuar, mungesë të të dhënave, ndryshime në afate, si dhe aktivitete që zbatohen vetëm formalisht, pa zbatim praktik.



Këto rreziqe do të identifikohen duke krahasuar të dhënat e marra nga burime të ndryshme, duke përfshirë dokumentet zyrtare, përgjigjet ndaj kërkesave për akses në informacion publik, të dhënat e disponueshme publikisht, njoftimet për median, raportet e përdoruesve, intervistat dhe burime të tjera relevante.

Rreziqet nuk do të trajtohen si një vlerësim i pavarur i suksesit ose dështimit të institucioneve, por më tepër si një element shtesë analitik që ndihmon në shpjegimin pse aktivitete të caktuara vonohen, zbatohen në një masë të kufizuar ose nuk prodhojnë efektin praktik të pritur.

Gjetjet për rreziqet do të paraqiten në raporte dhe kur është e përshtatshme, në platformën interaktive, në mënyrë që publiku të ketë njohuri jo vetëm nëse aktivitetet janë zbatuar, por edhe për arsyet e vonesave, ngecjes ose ndikimit të kufizuar.

12. Kufizimet e metodologjisë

Metodologjia është hartuar të jetë realiste, e verifikueshme dhe e zbatueshme, por ka kufizimet e veta. Saktësia dhe gjithëpërfshirja e gjetjeve do të varet nga disponueshmëria, cilësia dhe aktualiteti i të dhënave të publikuara ose të paraqitura nga institucionet përkatëse.

Në disa raste, mund të jetë e vështirë të përcaktohet me saktësi shkalla e zbatimit të një aktiviteti, veçanërisht kur informacioni është i paplotë, i vjetruar ose i paraqitur ndryshe në burime të ndryshme. Përveç kësaj, për disa aktivitete, mund të jetë e vështirë të izohet ndikimi i tyre i menjëhershëm, veçanërisht kur ato janë pjesë e proceseve më të gjera të reformës ose varen nga zbatimi i aktiviteteve të tjera.

Monitorimi financiar ka gjithashtu kufizime, pasi të dhënat e buxhetit nuk mbahen ose publikohen gjithmonë në nivelin e aktivitetit ose masës individuale. Në raste të tilla, do të kërkohet kryqëzim shtesë i të dhënave, kërkimi i informacionit nga institucionet dhe interpretimi i kujdesshëm i të dhënave financiare në dispozicion.

Metodologjia nuk pretendon të masë ndikimin afatgjatë të secilit aktivitet në uljen e korrupsionit ose në funksionimin e përgjithshëm të institucioneve. Fokusi i saj është në verifikimin e zbatimit, efektet e menjëhershme dhe ekzistencën e mbështetjes financiare.

Prandaj, vlerësimet dhe gjetjet do të bazohen në informacionin e disponueshëm dhe të verifikueshëm, dhe në rastet kur të dhënat janë të kufizuara ose nuk mund të konfirmohen nga burime të shumëfishta, kjo do të deklarohet qartë në shpjegim. Në këtë mënyrë, metodologjia ofron një qasje transparente dhe i lejon publikut të kuptojë jo vetëm se çfarë është përcaktuar, por edhe në bazë të cilave të dhëna dhe me çfarë kufizimesh.

13. Vërejtje përfundimtare

Kjo metodologji ofron një kornizë për një vlerësim objektiv të zbatimit të politikave kundër korrupsionit, duke bërë një dallim të qartë midis përmbushjes formale të detyrimeve dhe efektit të tyre substancial në praktikë. Duke zbatuar sistemin e semaforëve dhe duke monitoruar ndryshimet specifike, është e mundur të lokalizohet me saktësi përgjegjësia institucionale dhe arsyet specifike për vonesat e mundshme në zbatim.

Duke krijuar një sistem për gjenerimin e të dhënave të krahasueshme dhe të verifiku-eshme, dokumenti shërben si bazë për monitorimin e vazhdueshëm të angazhimeve institucionale. Disponueshmëria publike e gjetjeve dhe prezantimi i tyre transparent përmes platformës interaktive mundësojnë rritjen e llogaridhënies së institucioneve, duke e pozicionuar kështu metodologjinë si një instrument funksional për mbështetjen dhe zbatimin më efikas të Strategjisë Kombëtare.

SHTOJCA 1: *Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026–2030 dhe Plani i veprimit për zbatimin e saj 2026-2030 me masa monitorimi të përcaktuara*

